



## **Akademia e Kosovës në Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut**

*Në bashkëpunim  
me Qendrën për Arsim e Kosovës; Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Qendrën Evropiane Wergeland  
dhe Këshillin e Evropës*

**Kosovë\***  
**2-6 dhjetor 2015**

### **Hyrje:**

Shoqëritë demokratike dhe paqja mund të ndërtohen vetëm nga qytetarët demokratikë. Sot, si kurrë më parë, demokracia në shumë vende të Evropës është vënë në rrezik e sfidohet nga konfliktet dhe dhuna, nga racizmi, diskriminimi, ksenofobia dhe korrupsioni. Edukimi mund të jetë një vegël shumë e fuqishme për të adresuar këto sfida. Në të vërtetë, edukimi e ka rolin kyç në promovimin e respektit për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe respektimin e ligjit, dhe në përgatitjen e të rinjëve për një jetë aktive në shoqëritë demokratike.

Shkollat e kanë një potencial të madh për të ofruar hapësirë ku të rinjtë inkurajohen të mësojnë dhe ushtrojnë demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Por, si të zhvillojmë një kulturë demokratike të shkollës, që mund të shërbejë si shtyllë kurriore për shoqëritë demokratike?

Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNj), e miratuar me rekomandimin CM/Rec(2010), e promovon EQD/EDNj si mënyrën parësore për “*të pajisur nxënësit me njohuri, shkathtësi e vlera, dhe për të zhvilluar qëndrimet dhe sjelljet e tyre*”, në mënyrë që ata të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Përveç mësimit mësimdhënësve që qartazi luajnë një rol vital këtu, Karta pranon rolin e palëve tjera në edukim dhe në komunitet, për të bashkuar përpjekjet drejt krijimit të institucioneve demokratike.

Në Kosovë\*, *Korniza e Re Kurrikulare është ë bazuar në kompetenca*, njëra prej të cilave është kompetenca qytetare. Është një nevojë e madhe që të paraqiten metoda aktive të të nxënësve dhe vlera demokratike që qojnë në pajisjen e nxënësve me njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të domosdoshme për bashkëjetesë në shoqëri diverse.

### **Lidhur me Akademinë e Kosovës:**

Akademia e Kosovës është një trajnim në fushën e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe Edukimit për të Drejtat e Njeriut, i organizuar bashkarisht nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Prishtinë, Këshilli i Evropës (CoE) dhe European Wergeland Centre (EWC).

Akademia mbështetet në programin e Këshillit të Evropës “Të mësuarit e demokracisë dhe të drejtave të njeriut”, i financuar përmes kontributit vullnetar të Norvegjisë, dhe promovon qasjen tërëshkolllore në edukimin për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut.

Akademia po ashtu mbindërton punën e Këshillit të Evropës në Kosovë, siç është projekti “Interkulturalizmi dhe procesi i Bolonjës”. Brenda kornizave të këtij projekti, Këshilli i Evropës i ka përkthyer në gjuhët lokale materialet mësimdhënëse kyçe të EQD/EDNj (deri më 2011), dhe i ka akredituar te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Këto materiale do të përdoren gjatë trajnimit dhe do të vihen në praktikë në shkollat pjesëmarrëse.

\* “Të gjitha referimet për Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullatën, në këtë tekst do të kuptohen në pajtueshmëri me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës ”

### *Qëllimi dhe objektivat:*

Akademia ka për qëllim forcimin e kulturës demokratike në shkollat e komunës së Prishtinës duke trajnuar profesionistët e edukimit dhe aktorët komunitarë, si dhe duke zhvilluar më tej kapacitetin e tyre për ta zbatuar dhe promovuar EQD/EDNj në shkollat dhe komunitetet e tyre.

Në mënyrë më specifike Akademia do të:

- lehtësojë ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira në fushën e EQD/EDNj
- mbështetë pjesëmarrësit në zhvillimin dhe zbatimin e projektit shkollor
- inkurajojë bashkëpunimin dhe paetneritetin mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë në edukim dhe në mes të shkollave pjesëmarrëse
- mbështetë krijimin e një rrjeti të profesionistëve që promovojnë EQD/EDNj
- lehtësojë zbatimin e Kartës së Këshillit të Evropës për EQD/EDNj dhe përdorimin e materialeve të Këshillit të Evropës në nivelin lokal

### **Qasja e përgjithshme:**

Trajnimi do të ndjek qasjen tërëshkollore në EQD/EDNj dhe do të adresojë sfera të ndryshme të jetës shkollore: procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, qeverisjen shkollore dhe përfshirjen e komunitetit e partneritetin. Kjo qasje inkurajon pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të shkollës në ndërtimin e një mjedisi ku parimet e të drejtave të njeriut dhe demokracisë mund të mësohen dhe të praktikohen.

Trajnimi do të bazohet në materialet e Këshillit të Evropës në vijim:

- Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut
- Qeverisja demokratike e shkollave
- Si të gjithë mësimdhënësit mund të mbështesin edukimin qytetar: një kornizë për zhvillimin e kompetencave
- Manualët “Të jetuarit e demokracisë”
- Compass – manuali për edukimin për të drejtat e njeriut me të rinjtë
- Compasito – manuali për edukimin për të drejtat e njeriut për fëmijë

Në do të përdorim platformën elektronike të EWC-së Share&Connect (<http://shareandconnect.theewc.org>) për disa pjesë të trajnimit. Të gjitha materialet do të jenë në dispozicion në formë elektronike në hapësirën për grupin tuaj në Share&Connect, në gjuhë lokale nëse janë në dispozicion, si dhe në gjuhën angleze.

### **Përvijimi i Akademisë:**

Akademia Kosovare përbëhet nga tri fazat në vijim:

#### Faza 1: Faza përgatitore online – njohja me trajnimin (nëntor 2015)

Kjo fazë përcaktohet si njohje me seminarin trajnues. Qëllimi kryesor është të njihemi me njëri tjetrin dhe të familjarizohemi me materialet mësimore të Këshillit të Evropës, konceptet, qasjet dhe aktivitetet e EQD/EDNj.

#### Faza 2: Seminari trajnues pesëditor (2 – 6 dhjetor 2015)

Seminari është bërthama e Akademisë. Trajnerët dhe pjesëmarrësit punojnë së bashku dhe ndajnë përvojat e tyre me EQD/EDNj. Pjesëmarrësit analizojnë situatën aktuale në shkollën dhe komunitetin e tyre dhe reflektojnë për praktikën e tyre në dritën e parimeve të EQD/EDNj. Bazuar në këto analiza dhe të mbështetur nga trajnerët, secili ekip shkollor zhvillon një projekt shkollor të drejtuar kah nxitja e kulturës demokratike.

#### Faza 3: Faza përcjellëse (janar – maj 2016)

Në këtë fazë mbështeten pjesëmarrësit në zbatimin e projekteve të tyre shkollore. Përgjatë kësaj faze trajnerët ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për të gjitha ekipet përmes platformës elektronike të EWC-së Share & Connect. Po ashtu, një takim përcjellës do të organizohet në shkurt apo mars 2016 për të diskutuar progresin e projekteve shkollore, bashkëpunimin në vijim dhe për të planifikuar aktivitetet vlerësuese.

### **Grupi në shënjestër dhe profili i pjesëmarrësve:**

Pjesëmarrësit janë të ftuar t'i bashkohen Akademisë si ekip prej tre anëtarëve. Secili ekip përbëhet prej dy përfaqësuesve të shkollës, përfshirë drejtorin apo zëvendësdrejtorin dhe një mësimdhënës, së bashku me një

përfaqësues të shoqatës së prindërve apo një OJQ-je që tashmë bashkëpunon me shkollën ose dëshiron ta bëjë këtë.

Akademia ofrohet për ekipet prej shkollave të komunës së Prishtinës.

### **Gjuhët e punës:**

Trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe (varësisht nga nevojat e pjesëmarrësve).

### **Trajnerët/ekspertët:**

Trajnimi do të ofrohet nga një ekip më përvojë i trajnerëve/ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë

### **Vendi:**

Kosovë, lokacioni për t'u caktuar

### **Shpenzimet:**

Shpenzimet e rrugës, akomodimit, ushqimit dhe të gjitha aktiviteteve të përfshira në programin e trajnimit janë të mbuluara nga organizatorët.

### **Procedura e aplikimit dhe përzgjedhjes:**

Aplikimi duhet të bëhet si ekip. Ju lutem gjeni formën e aplikimit dhe kriteret e përzgjedhjes. Aplikimet duhet të dorëzohen më së largu deri më **9 shtator 2015**, përmes e-mailin në: [vsylhasi@kec-ks.org](mailto:vsylhasi@kec-ks.org), dhe duke kopjuar edhe [arberienagavci@hotmail.com](mailto:arberienagavci@hotmail.com)

KEC dhe DKA Prishtinë do të zgjedhin 11 ekiye (33 pjesëmarrës) mbi bazën e profileve të tyre. Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh barazia mes gjinive, përvoja në EQD/EDNj, motivimi dhe idetë për shpërndarje në shkollë. Vetëm ekipet që do të zgjedhen, do të informohen për pjesëmarrjen më së largu më **30 shtator 2015**.

### **Certifikata e pjesëmarrjes:**

Pjesëmarrësit që do ta kompletojnë Akademinë do të marrin certifikata të pjesëmarrjes.

### **Informata tjera:**

Suksesi i aktiviteteve trajnuese varet nga përkushtimi i të gjithë pjesëmarrësve. Duke pranuar të marrin pjesë në Akademi, pjesëmarrësit pajtohen të marrin pjesë aktivisht në të gjitha fazat e trajnimit.

### **Kontakti:**

#### **Qendra për Arsim e Kosovës (KEC):**

Personi kontaktues: Veton Sylhasi, koordinator  
Tel: +377 44 154 644  
Fax:  
E-mail: [vsylhasi@kec-ks.org](mailto:vsylhasi@kec-ks.org)  
Website: [www.kec-ks.org](http://www.kec-ks.org)